

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit B. B. nga fshati K. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprave penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KPK dhe kanosje nga neni 185 par.1 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.932-2/2016 të datës 19.07.2016, pas mbajtjes së seancës fillestare publike në praninë e prokurorit të shtetit Mehdi Sefa, të akuzuarit dhe dëmtuarave H. G. nga Prizreni e L. G. nga fshati L. Komuna e S., me datë 09.08.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B. B. nga i ati L. dhe e ëma H. e lindur K., i lindur më datë *data e lindjes...* në fshatin K. Komuna e Prizrenit ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, punëtor i ndërtimtarisë, i pa martuar, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

I.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 16.04.2016 rreth orës 22:30 minuta, në Prizren në Sheshin “Shadërvan” i shkakton lëndime trupore të dëmtuarës i cili rezulton me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, për shkak të problemeve familjare në mesë të akuzuarit dhe ish bashkëshortes së tij rreth ndarjes, derisa ajo ka qenë me nënën e saj dhe fëmijët, i akuzuari e sulmon fizikisht të dëmtuarën H. G. – nënën e ish bashkëshortes ashtu që e godet me shuplaka në pjesë të ndryshme të trupit, me ç’rast i shkakton lëndime trupore dhe atë: ndrydhje në shpinë dhe në shuplakën e dorës së djathë, të cilat lëndime kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor, me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Këso dore ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KPK.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 188 par.1 nën part.1.4 të KPK të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

E dëmtuara H. (S.) G. nga Prizreni rruga ... pa nr. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

I akuzuari obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të ekspertit mjeko ligjore për ekspertizë të paguaj shumën prej 20 €, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Mbikëqyrjen e dënimit me kusht do të bëjë Shërbimi Sprovues në Prizren, në pajtim me nenin 150 par.1 të LESP.

II.

Në pajtim me nenin 363 par.1 nën par.1.3 të KPPK

REFUZOHET AKUZA

Me datë 16.04.2016 rreth orës 23:00, në Prizren në Stacionin e Policisë seriozisht i kanoset të dëmtuarës me fjalë se do të shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit, në atë mënyrë që për shkak të raporteve jo të mira në mes të akuzuarit dhe ish bashkëshortes së tij – të dëmtuarës L. G., lidhur me kontaktin me fëmijët e tyre të përbashkët, i akuzuari e kanos përmes telefonit celular dhe i dërgon mesazh “thirrëm ma mirë të bjen, a e dinë çka ka me të gjet, pse spo mi len mi pa fëmijët”, me ç’rast tek e dëmtuara ka shkaktuar frikë, ankth dhe pasiguri – ia ka rrezikuar sigurinë personale.

Kësodore kishte për të kryer veprën penale kanosje nga neni 185 par.1 të KPK.

Për shkak se në shqyrtimin kryesor prokurori i shteti ka hequr dorë nga ndjekja penale, andaj në mbështetje të nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPPK është refuzuar akuza.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.932-2/2016 të datës 19.07.2016, kundër të akuzuarit B. B. nga fshati K. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprave penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KPK dhe kanosje nga neni 185 par.1 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit. I akuzuari pas kësaj deklaroj se e ka kuptuar aktakuzën dhe nuk e kundërshton provat materiale.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike me datë 16.04.2016 rreth orës 22:30 minuta, në Prizren në Sheshin “Shadërvan”, për shkak të raporteve jo të mira në mes të akuzuarit B. B. dhe ish bashkëshortes së tij, derisa ajo ka qenë me fëmijët e saj dhe nënën - të dëmtuarës H. G., i akuzuari e sulmon fizikisht të dëmtuarën e godet me shuplaka në pjesë të ndryshme të trupit, me ç’rast i shkakton lëndime trupore dhe atë: ndrydhje në shpinë dhe në shuplakën e dorës së djathtë, të cilat lëndime kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike ka vërtetuar në shqyrtimin fillestar ku i akuzuari vullnetarisht ka pranuar fajësinë për veprën penale lëndimi i lehtë trupor, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Mirëpo gjykata sipas detyrës zyrtare nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, për veprën penale e cila i vihet në barrë e cila mbështetet në fakte dhe prova materiale, të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari është njoftuar me kohë. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 246 të KPPK dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KPK dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin si në shqiptim të aktgjykimit duke e vërtetuar përgjegjësinë penalo juridike.

Në shqyrtimin fillestar – në seancën e datës 09.08.2017 pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, e dëmtuara L. G. deklaroi se vullnetarisht tërhiqet nga propozimi për ndjekje penale, kundër të akuzuarit B. B., për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par.1 të KPK. E dëmtuara theksoj se me të akuzuarin ka shkëputur lidhjen martesore, tani jeton vetëm në fshatin L. Komuna e S. dhe i akuzuari nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim kundërligjor ndaj saj. Andaj propozon gjykatës dhe prokurorit të shtetit që kjo procedurë të përfundoj në mënyrë që çështja të mbyllet pasi që tërheq propozimin për ndjekjen penale të akuzuarit, për veprën penale objekt i akuzës.

Prokurori i shtetit duke u bazuar në deklaratën e dëmtuarës L. G. dhënë në shqyrtimin fillestar, ku vullnetarisht është tërhequr nga propozimi për ndjekjen penale në dëm të saj, andaj edhe përfaqësuesi i akuzës, është tërhequr nga akuza për veprën penale si në dispozitivin nën **II.** të aktakuzës, pasi që vepra penale e kanosjes nga neni 185 par.1 të KPK, fillon sipas propozimit të dëmtuarit.

Meqenëse prokurori shtetit gjatë shqyrtimit fillestar është tërhequr nga aktakuza kundër të akuzuarit, gjykata në pajtim të nenit 363 par.1 nën par.1.1 të KPPK, ka vendosur si në shqiptim të aktgjykimit.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPK, të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana rënduese, si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit, rrethanat familjare, gjendja ekonomike e akuzuarit, që do të thotë është mbajtës i familjes, pendimi për kryerjen e veprës penale, premtimin se në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e këtylla, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj të akuzuarit i shqipton dënimin me burgim, në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, nëse nuk kryen vepër të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprime të tilla.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarës në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, gjykata e morri në pajtim me nenin 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të KPPK.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1530/2016 të datës 09.08.2017

Procesmbajtësja
Myrvete Përdibuka

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.